



GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Buletini Informativ

Janar — Qershor 2019

Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS2

VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....5

AKTGJYKIME11

GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME15

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja e Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata aktualisht përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë vendor.






Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 korrik – 30 qershor 2019, Gjykata ka pranuar 109 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 276 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 101 kërkesa janë zgjidhur ose 38% e të gjitha rasteve në dispozim.

Gjatë kësaj periudhe, 72 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranuar sipas muajve
(1 janar – 30 qershor 2019)*



Në vijim janë paraqitur 8 aktgjykimet që Gjykata nxori gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 janar – 30 qershor 2019:

- Aktgjykim në rastin KI 01/18, parashtruar nga: Gani Dreshaj dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. A. – U. ZH. nr. 64/2017, të 26 dhjetorit 2017.
- Aktgjykim në rastin KI 48/18, parashtruar nga: Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U. ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017.
- Aktgjykim në rastin KO 162/18, parashtruar nga: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamentit të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, të propozuar nga 80 (tetëdhjetë) deputetë të Kuvendit të Republikës së

Kosovës dhe të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 24 tetor 2018, me shkresën nr. 06/2156/DO-1156.

- Aktgjykim në rastin KO 157/18, parashtruar nga: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 14, paragrafit 1.7 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës.

- Aktgjykim në rastin KI 87/18, parashtruar nga: Kompania e Sigurimeve „IF Skadeforsikring“. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 27/2017, të 24 janarit 2018.

- Aktgjykim në rastin KI 31/18, parashtruar nga: Komuna e Pejës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit, E. Rev. nr. 20/2017, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 20 nëntorit 2017.

- Aktgjykim në rastin KO 171/18, parashtruar nga: Avokati i Popullit. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

- Aktgjykim në rastin KO 43/19, parashtruar nga: Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë.


Llojet e shkeljeve të pretenduara

Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 109 kërkesat e pranuar gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 janar – 30 qershor 2019, janë si në vijim:

- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], 16 raste ose 14,7%;
- Neni 23 [Dinjiteti i njeriut], 2 raste ose 1,8 %;
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 10 raste ose 9,2 %;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 41 raste ose 37,6 %;

- Neni 32 [E drejta për mjete juridike], 1 rast ose 0,9%;
- Neni 46 [Mbrotjtja e pronës], 9 raste ose 8,3%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 4 raste ose 3,7%;
- Neni 54 [Mbrotjtja gjyqësore e të drejtave], 11 raste ose 10,1%;
- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të institucioneve shtetërore, 2 raste ose 1,8%;
- Shkelje të tjera, 13 raste ose 11,9%;


*Shkeljet e pretenduara, sipas llojit të shkeljeve
(1 korrik – 31 dhjetor 2018)*



Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 99 ose 90,8% të kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave
- 10 ose 9,2% të kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike

*Shkelësit e supozuar të të drejtave
(1 janar – 30 qershor 2019)*




Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 76 kërkesa nga shqiptarët, ose 69,7%;
- 7 kërkesa nga komuniteti serb, ose 6,4%;
- 1 kërkesa nga komuniteti boshnjak, ose 0,9%;
- 8 kërkesa nga komunitetet e tjera, ose 7,3%;
- 17 kërkesa janë parashtruar nga autoritetet e tjera publike (personat juridikë), ose 15,6%;

*Struktura etnike e parashtruesve të kërkesave
(1 janar – 30 qershor 2019)*



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 janar – 30 qershor 2019, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 21 seanca plenare dhe 84 kolegje shqyrtuese, në të cilat, rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime.


Gjatë kësaj periudhe gjashtëmuajore, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 72 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 8 Aktgjykime (11,1%);
- 54 Aktvendime për papranueshmëri (75%);
- 1 Aktvendim për papranueshmëri, refuzim i kërkesës për Masë të Përkohshme (1,4%);
- 5 Vendime për refuzim i kërkesës me procedurë të shkurtër (6,9%);
- 1 Vendim për hedhje poshtë të kërkesës (1,4 %);

- 1 Vendim për heqjen e kërkesës nga lista (1,4%);
- 2 Vendime për Masë të Përkohshme (2,8%);

*Struktura e vendimeve
(1 janar – 30 qershor 2019)*



10 janar 2019



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Artë Rama-Hajrizi, dhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhmi Rexhepi, pritën në takim njohës ambasadorin e ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, z. Philip Kosnett. Pasi që i uroi suksese në detyrën e tij të re, kryetarja Rama-Hajrizi fillimisht e njoftoi ambasadorin Kosnett me punën e deritanishme të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, si dhe me sfidat me të cilat është përballur ky institucion gjatë vitit që shkoi, veçanërisht në aspektin e funksionimit dhe të vendimmarrjes.

Largimi i njëkohshëm i katër gjyqtarëve të gjeneratës së parë të emëruar në Gjykatën Kushtetuese dhe humbja e kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje vitin e kaluar, ishin ndër sfidat kryesore të cilat kryetarja Rama-Hajrizi i veçoi në takim. Ajo theksoi se, që nga themelimi në vitin 2009, Gjykata Kushtetuese tek tani në përbërjen e saj ka vetëm gjyqtarë vendorë, me ç'rast shprehu falënderimin për kontributin dhe për punën e çmuar të gjyqtarëve të larguar ndërkombëtarë. Në vazhdim të bisedës kryetarja Rama-Hajrizi diskutoi mbi zhvillimet e fundit në gjyqësinë kushtetuese të Kosovës, mundësitë e konsolidimit të mëtejshëm të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, si dhe reformat e nevojshme legislative në funksion të forcimit të sundimit ligjit.

Ajo shprehu falënderimin dhe mirënjohjen për ndihmën që Qeveria e SHBA-së i ka ofruar deri më tani Gjykatës Kushtetuese, por edhe institucioneve të tjera në vend, nëpërmjet projekteve të financuara nga Misioni i USAID-it në Kosovë.

Pasi që falënderoi kryetaren Rama-Hajrizi për mikpritjen, ambasadori Kosnett konfirmoi përkrahjen e tij për pavarësinë në punë të Gjykatës Kushtetuese dhe shprehu zotimin për thellimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve mike, në të gjitha fushat me interes reciprok.

5 mars 2019

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Artë Rama-Hajrizi, priti në takim gjyqtarin me prejardhje shqiptare të Gjykatës Rajonale të Australisë Jugore me seli në Adelaide, z. Rauf Soulio, i cili njehëresh shërben edhe si Konsull nderi i Republikës së Kosovës dhe i Republikës së Shqipërisë në Australi. Sistemi gjyqësor dhe kushtetues në Republikën e Kosovës, roli dhe funksioni që ka Gjykata Kushtetuese në vend, si dhe sfidat në vendimmarrjen e saj, ishin ndër temat që u diskutuan në takimin e përbashkët.

Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim i bëri një përshkrim të shkurtër edhe historikut të formimit të Gjykatës Kushtetuese, me ç'rast vuri theksin në rolin me rëndësi që kanë pasur partnerët ndërkombëtarë në funksionalizimin e saj, si dhe në kontributin e çmuar të ish-gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës në themelimin e praktikës gjyqësore sipas standardeve evropiane të gjyqësisë kushtetuese.



Gjyqtari Soulio, pasi që falënderoi kryetaren Rama-Hajrizi për mikpritjen, shprehu gatishmërinë e tij për vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nëpërmjet shkëmbimit të përvojave profesionale dhe realizimit të vizitave studimore të studentëve shqiptaro-australian në lëmin e drejtësisë.

21 mars 2019

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe me përkrahjen e ambasadës së Norvegjisë në Kosovë, organizuan punëtorinë e përbashkët me temë: “Përmirësimi i mbrojtjes së standardeve evropiane të të drejtave të njeriut nga Gjykata Kushtetuese”, e cila u mbajt në hotelin “Swiss Diamond Hotel” në Prishtinë. Punëtorja e mbajtur shënoi edhe fillimin e projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga ambasada e



Norvegjisë në Kosovë, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe komunikimin me publikun. Me një fjalë rasti, pjesëmarrësve në këtë punëtori iu drejtuan kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, shefja e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, znj. Isabelle Servoz-Gallucci, ambasadori i Norvegjisë në Kosovë, z. Per Strand Sjaastad, si dhe udhëheqësi i Departamentit për Evropën juglindore dhe Turqinë në kuadër të Këshillit të Evropës dhe njëherësh koordinator i këtij projekti, z. Daniel Schmidt.

Pasi që shprehu mirënjohjen e saj për mbështetjen e vazhdueshme të ofruar Gjykatës Kushtetuese nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga ambasada norvegjeze, kryetarja Rama-Hajrizi ndër të tjera tha se, *“ky projekt pritet të ndihmojë edhe më shumë Gjykatën Kushtetuese të Kosovës që të përmbush misionin e saj në mbrojtjen dhe zbatimin e kushtetutshmërisë në vend, veçanërisht tani që po hyjmë në dekadën e parë të punës dhe pas largimit të gjyqtarëve dhe të këshilltarëve ndërkombëtarë”*.



Pavarësia e gjykatave kushtetuese dhe e gjykatave rajonale në trajtimin e rasteve me të drejta të njeriut, ishte njëra ndër temat për të cilat u diskutua në vazhdim të punëtorisë, ku në mesin e panelistëve folës ishte edhe z. Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

26 mars 2019

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim ministren e Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë,

znj. Etilda Gjonaj. Puna e deritanishme e Gjykatës Kushtetuese, sfidat e përballura gjatë përzgjedhjes së gjyqtarëve të rinj dhe largimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë vitin e kaluar, ishin vetëm disa prej çështjeve për të cilat kryetarja Rama-Hajrizi diskutoi në takimin e përbashkët me ministren Gjonaj. Ajo e vlerësoi lartë ecurinë që ka bërë Shqipëria në reformimin e sistemit të drejtësisë nëpërmjet procesit të Vettingut, duke nënvizuar rëndësinë që ka për konsolidimin e shtetit të së drejtës në çdo vend, emërimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve me integritet. Kryetarja Rama-Hajrizi më tutje tha se, ashtu si edhe



të gjitha institucionet shtetërore të të dyja vendeve, edhe gjykatat kushtetuese të Kosovës dhe të Shqipërisë kanë kultivuar një bashkëpunim të shkëlqyer ndër vite, duke pasur çdo herë si udhërrëfyes standardet evropiane të gjyqësisë kushtetuese.

Ministrja Gjonaj theksoi nga ana e saj gatishmërinë e shtetit shqiptar për të vazhduar përkrahjen për të gjitha institucionet dhe për të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon Kosova, si dhe për të forcuar raportet e gjithanshme të bashkëpunimit, në veçanti në fushën e drejtësisë. Në vazhdim të takimit të dyja palët shkëmbyen idetë dhe përvojat reciproke për sa i përket sistemeve gjyqësore të të dyja vendeve, me fokus të veçantë në pavarësinë e gjyqësorit, si dhe praktikat e përzgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues.

8 prill 2019

Nxënës të shkollave fillore nga qytete të ndryshme të Republikës së Kosovës vizituan Gjykatën Kushtetuese me rastin e shënimit të 11-vjetorit të Kushtetutës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2008. Ata u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Arta Rama-Hajrizi, e cila pasi që u shprehi mirëseardhjen, i njoftoi në pika të shkurtra me funksionin dhe rolin me rëndësi që ka Gjykata Kushtetuese për sundimin e ligjit në vend, si dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut sipas standardeve evropiane.

Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim i njoftoi filloristët edhe me strukturën organizative të Gjykatës dhe përbërjen e saj, me procesin e zgjedhjes dhe mandatin e gjyqtarëve kushtetues, si dhe me procedurat e shqyrtimit të kërkesave të parashtruara. Ajo foli edhe për procesin e hartimit të Kushtetutës së re të Republikës së Kosovës, si dhe për rëndësinë që ka ky dokument jo vetëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend, por edhe për të gjitha proceset e zhvillimit demokratik të shoqërisë tonë.



Pasi që u përgjigj në pyetjet e shumta të nxënësve, kryetarja Rama-Hajrizi në përmbyllje të takimit u dhuroi atyre nga një kopje të Kushtetutës, me urimin që gjithë së bashku ta respektojmë dhe të zbatojmë çdo nen të saj, për të siguruar një të ardhme më të mirë për gjeneratat e reja.

Vizita e nxënësve u realizua nën organizimin e përbashkët të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të Programit për Transformim të Liderit (TLP) të Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

17 prill 2019

Gjykatën Kushtetuese e vizituan studentët e vitit të katërt të Fakultetit Juridik të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren, të shoqëruar nga profesori universitar dhe ish-nënkryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Prof. dr. Kadri Kryeziu. Studentët u pritën në takim nga zëvendës-këshilltari i parë juridik i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhat Kelmendi, dhe nga drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim (ZKI), z. Veton Dula.



Gjatë takimit të mbajtur, këshilltari Kelmendi fillimisht i njohu studentët me funksionin, me përgjegjësitë dhe me rolin që ka Gjykata Kushtetuese e Kosovës në raport me organet e tjera të pushtetit shtetëror dhe me gjykatat e rregullta në vend. Këshilltari Kelmendi në vazhdim bëri një prezantim të shkurtër përkitazi me palët e autorizuar sipas

Kushtetutës për të parashtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, me ç'rast për secilën palë parashtruese ai bëri një elaborim krahasues me vendimet e nxjerra deri më tani nga gjykata. Ai diskutoi edhe për aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese që kanë pasur më së shumti ndikim në sundimin e së drejtës dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend, duke theksuar njëherësh obligimin kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Për bashkëpunimin e Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias, parashtrimin e kërkesave nga dhe në Forumin e Komisionit të Venecias, si dhe numrin e përgjithshëm të kërkesave të parashtruara deri më tani, studentët u informuan më në detaje nga drejtori i ZKI dhe njëherësh Zyrtari ndërlidhës i Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias, z. Veton Dula.

18 prill 2019

Gjykatën Kushtetuese e vizitoi një grup studentësh të Fakultetit Juridik të Kolegjit “AAB” në Prishtinë. Studentët u pritën në takim nga këshilltari juridik senior i Gjykatës Kushtetuese, z. Bardh Bokshi dhe nga drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim (ZKI), z. Veton Dula.



Këshilltari Bokshi fillimisht i njoftoi studentët më për së afërmi me strukturën organizative dhe me përbërjen e Gjykatës, me procedurat për përzgjedhjen dhe për emërimin e gjyqtarëve kushtetues, me procesin e vendimmarrjes së Gjykatës, si dhe me kompetencat dhe përgjegjësitë që gëzon Gjykata Kushtetuese në bazë të Kushtetutës.

Në vazhdim të takimit, këshilltari Bokshi veçoi disa prej aktgjyimeve më me rëndësi të Gjykatës në fushën e shkeljes së të drejtave të njeriut nga autoritetet publike, konfliktit të kompetencave kushtetuese ndërmjet organeve të ndryshme të pushtetit shtetëror, si dhe ruajtjes së pavarësisë funksionale të institucioneve të pavarura.

Ai diskutoi edhe për rëndësinë dhe obligimin kushtetues për zbatimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, si dhe të gjykatave të niveleve të tjera të gjyqësorit të rregullt në Republikën e Kosovës. Studentët nga ana e tyre shprehën interesimin që të informohen më në detaje përkitazi me zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, procesin e parashtrimit të kërkesave në Gjykatë, natyrën e kërkesave të parashtruara, kohëzgjatjen e shqyrtimit të

të lëndëve, si dhe për trajtimin e pyetjeve të mediave dhe publikut rreth lëndëve në shqyrtim.

22 prill 2019

Një delegacion i gjyqtarëve dhe këshilltarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga kryetarja e Gjykatës, znj. Arta Rama-Hajrizi, qëndroi për një vizitë pune disaditëshe në Uashington, më 14–22 prill 2019. Gjatë qëndrimit në kryeqytetin amerikan, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese vizitoi Gjykatën e Qarkut të SHBA-ve për Qarkun e Kolumbisë (DC), Gjykatën e Apelit të Qarkut të DC, si dhe Gjykatën Supreme të Shteteve të Bashkuara, ku pati mundësinë edhe të marrë pjesë në prezantimin dhe në argumentimin oral të rastit, *“Shtetet e Bashkuara kundër Davis”*.



Në vazhdim të qëndrimit në Uashington, gjyqtarët dhe këshilltarët e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës vizituan edhe Qendrën Federale Gjyqësore, si dhe Zyrën Administrative të Gjykatave të Shteteve të Bashkuara, për të mësuar më shumë rreth rolit të Zyrës Administrative, etikës gjyqësore në Shtetet e Bashkuara, si dhe raportit të gjyqësorit federal me mediat dhe me publikun.

Pas vizitës në Byronë e Agjencisë USAID për Evropë dhe Euroazi, qëndrimi i delegacionit të Gjykatës Kushtetuese në Uashington u përmbyll me vizitën në Fakultetin Juridik të Universitetit Amerikan, ku ndër të tjera, u diskutua mbi të drejtën kushtetuese dhe teorinë e interpretimit kushtetues, si dhe interpretimin e kriterëve të pranueshmërisë në përzgjedhjen e lëndëve për shqyrtim. Vizita e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese në SHBA u mundësua me mbështetjen e Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP).

16 maj 2019

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, në krye me kryetarin e kësaj gjykate, z. Miroslav Šeparović, qëndroi për vizitë pune në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Delegacioni kroat u prit në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi dhe zëvendëskryetari i Gjykatës, z. Bajram Ljatifi.

Gjatë takimit që u zhvillua në një atmosferë të përzemërt dhe miqësore, kryetarja Rama-Hajrizi i informoi mysafirët me punën e deritanishme të

përbërjes së gjyqtarëve kushtetues vitin e kaluar, si dhe me sfidat e tejkaluara me sukses pas zëvendësimit të ish-gjyqtarëve ndërkombëtarë me gjyqtarë vendor.



Kryetarja Rama-Hajrizi në vazhdim e falënderoi homologun e saj kroat, z. Šeparović, për përkrahjen që Gjykata Kushtetuese e Kroacisë i ka ofruar në vazhdimësi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në përpjekjet për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, si dhe në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të saj nëpërmjet projekteve të përbashkëta për shkëmbim përvojash.

Ajo u zotua për intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet dy gjykatave homologe, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellë veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe harmonizimit të praktikës gjyqësore me atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Pasi që e falënderoi kryetaren Rama-Hajrizi për mikpritjen, kryetari Šeparović bëri një përkrahje të përgjithshme të funksionimit të gjyqësorit kushtetues në Republikën e Kroacisë dhe konfirmoi vullnetin e palëkundur për vazhdimin e bashkëpunimit ndërmjet dy gjykatave në të gjitha fushat me interes reciprok.



Pas takimit, gjyqtarët e të dy gjykatave kushtetuese mbajtën një punëtori të përbashkët në temat: *“Kompetenca e gjykatës kushtetuese përkitazi me shqyrtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare”*, *“Marrëveshjet kolektive para Gjykatës Kushtetuese”* dhe *“Mosmarrëveshjet zgjedhore nga perspektiva e gjykimit kushtetues”*.

të lëndëve, si dhe për trajtimin e pyetjeve të mediave dhe publikut rreth lëndëve në shqyrtim.

21 maj 2019



Studentë të vitit të parë të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, vizituan Gjykatën Kushtetuese, të cilët në takim i pritën gjyqtari i Gjykatës, z. Bekim Sejdiu dhe këshilltari juridik senior, z. Bardh Bokshi. Gjatë bashkëbisedimit me studentë, gjyqtari Sejdiu diskutimin e tij e përqendroi kryesisht në rolin që luan Gjykata Kushtetuese në mbrojtjen e kushtetutshmërisë në vend dhe në garantimin e funksionimit të organeve shtetërore në harmoni me përgjegjësitë dhe me obligimet e tyre kushtetuese. Procedurat e zbatuara në shqyrtimin e parashtresave kushtetuese, procesi dhe fazat e shqyrtimit të tyre, përzgjedhja e kolegjeve shqyrtuese të gjyqtarëve dhe mënyra e vendimmarrjes ishin po ashtu temë e prezantimit të gjyqtarit Sejdiu. Këshilltari Bokshi ndërkaq studentët i njoftoi më hollësisht me disa prej vendimeve më me rëndësi të Gjykatës dhe ndikimin që ato patën në vendosjen e praktikës gjyqësore kushtetuese në vend. Raporti me gjykatat e rregullta, zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga institucionet e tjera, si dhe kriteret për pranueshmërinë e kërkesave të palëve parashtruese, ishin çështjet për të cilat juristët e ardhshëm shprehën interesimin e tyre në vijim të takimit.

27 maj 2019



Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës organizuan punëtorinë e përbashkët në temën: *“Roli dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Raporti me gjykatat e rregullta dhe institucionet tjera”*, e cila u mbajt në gjykatoren e Gjykatës Kushtetuese. Punëtorja e mbajtur pati për qëllim informimin e gjyqtarëve të rinj të Kosovës, me autoritetin dhe me rolin që ka Gjykata Kushtetuese në raport me gjyqësorin e rregullt, si dhe me institucionet e tjera në vend, për të cilat ata u njoftuan më për së afërmi nga këshilltari i parë juridik i Gjykatës, z. Sevdail Kastrati. Procedurat e parashtrimit dhe të

shqyrtimit të lëndëve, trajtimi i ankesave individuale ndaj vendimeve të gjykatave të rregullta, si dhe e drejta e referimit të rasteve në shqyrtim nga gjykatat e rregullta në Gjykatën Kushtetuese nëpërmjet kontrollit incidental (konkret), ishin vetëm disa prej temave rreth të cilave këshilltari Kastrati në vazhdim përqendroi prezantimin e tij. Shqyrtimi i kërkesave që kanë të bëjnë me tejzgjatjen e procedurave gjyqësore nga gjyqësori i rregullt, afatet kohore për shqyrtimin e lëndëve në Gjykatën Kushtetuese dhe trajtimi i lëndëve me prioritet, sidomos në rastin e kërkesave të parashtruara nga autoritetet publike, ishin disa nga çështjet për të cilat gjyqtarët e rinj shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht. Përkritazi me marrëdhënien e bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe Komisionit të Venecias, mysafirët i njoftoi më në detaje Drejtori i Zyrës për Komunikim dhe Informim, z. Veton Dula, njëherësh Zyrtar ndërlidhës i Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias.

27 maj 2019



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim ish-gjyqtaren e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) nga Maqedonia e Veriut dhe ish-gjyqtaren e Gjykatës Kushtetuese të këtij vendi, znj. Mirjana Lazarova-Trajkovska. E angazhuar në cilësinë e ekspertes në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga ambasada e Norvegjisë në Kosovë, znj. Lazarova – Trajkovska qëndroi për vizitë pune njëjavore në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim të shkëmbimit të përvojës personale si ish-gjyqtare e GJEDNJ-së dhe për zbatimin e praktikave më të mira të punës nga ky institucion, së bashku me gjyqtarët dhe me këshilltarët e rinj të Gjykatës. Gjatë bashkëbisedimit me znj. Lazarova-Trajkovska, kryetarja Rama-Hajrizi vuri theksin në konsolidimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese duke pasur gjithmonë si udhërrëfyes praktikën gjyqësore të

GJEDNJ-së, në raportet e shkëlqyera të bashkëpunimit me gjykatat kushtetuese të vendeve të rajonit dhe me ato evropiane, si dhe në përpjekjet e vazhdueshme që po bëhen për avancimin e cilësisë së procesit vendimmarrës të Gjykatës.

Kryetarja Rama-Hajrizi falënderoi në veçanti Zyrën e Këshillit të Evropës për mbështetjen e ofruar Gjykatës Kushtetuese ndër vite nëpërmjet projekteve të ndryshme për ngritje të kapaciteteve profesionale, përfshirë këtu edhe projektin e fundit që filloi së zbatuari në mars të këtij viti, nëpërmjet të cilit synohet zbatimi më efektiv i standardeve evropiane në trajtimin e ankesave kushtetuese individuale dhe komunikimi më efikas me publikun.

6 qershor 2019



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim Avokatin e Popullit të Republikës së Shqipërisë, znj. Erinda Ballanca, të shoqëruar nga homologu i saj në Kosovë, z. Hilmi Jashari. Pasi që i shprehu mirëseardhjen, kryetarja Rama-Hajrizi e njoftoi znj. Ballanca me të arriturat e fundit që ka shënuar Kosova në fushën e gjyqësisë kushtetuese, si dhe me sfidat e përballura në punën e Gjykatës Kushtetuese gjatë vitit të kaluar, pas largimit të njëkohshëm të katër gjyqtarëve, dy prej tyre ndërkombëtarë.

Ajo vuri theksin në raportet e shkëlqyera me institucionet homologe në rajon, e veçanërisht me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, si dhe në përpjekjet e vazhdueshme që po bëhen për konsolidimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës, duke u bazuar në standardet e përfaqësuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në takim u theksua edhe nevoja e bashkëpunimit ndërinstitutional ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për plotësimet e nevojshme të kuadrit ligjor, me qëllim të thellimit të reformave të mëtutjeshme në sistemin gjyqësor të të dyjave vendeve dhe për përvetësimin e praktikave evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Të dyja palët gjithashtu nënvizuan rëndësinë e respektimit të ndarjes së pushteteve dhe ruajtjen e pavarësisë funksionale të gjykatave dhe të institucioneve të pavarura, si parakusht thelbësor për funksionimin e demokracisë kushtetuese në çdo vend.

7 qershor 2019



Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë organizuan punëtorinë e përbashkët në temën: “Standardet evropiane për të drejtat e njeriut mbi kohëzgjatjen e arsyeshme të procedurave”, e cila u mbajt në “Hotel Garden” në Prishtinë. Koncepti i kohëzgjatjes së arsyeshme në procedimin e kërkesave, vështruar nga perspektiva e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, arsyet më të shpeshta për vonesat në procedurë gjyqësore, mekanizmat parandalues dhe kompensues në rastet e procedurave të tejzgjatura, si dhe standardet evropiane për të drejtat e njeriut mbi kohëzgjatjen e arsyeshme të procedurave, ishin vetëm disa prej temave që u diskutuan në punëtori.

Panelistë dhe folës kryesor në punëtorinë e organizuar ishin: z. Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, z. Miodrag Gjorgjeviq, zëvendëskryetar i Gjykatës Supreme të Sllovenisë, znj. Maria Filatova, ish-avokate në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe znj. Mirela Bogdani, ligjëruese në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Punëtorja e mbajtur shënon aktivitetin e radhës në kuadër të projektit të mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe nga ambasada e Norvegjisë në Kosovë, që synon avancimin e kapaciteteve profesionale të Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të zbatimit më efektiv të standardeve evropiane në trajtimin e ankesave individuale dhe komunikimin me publikun.



Aktgjykim

KI 84/18

Parashtrues

Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit AA. nr. 52/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 25 nëntorit 2017 dhe Aktgjykimit A.A. U.ZH. nr. 62/2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të 7 dhjetorit 2017

Kërkesa KI48/18 u parashtrua nga z. Arban Abrashi dhe Lidhja Demokratike e Kosovës. Abrashi ishte kandidat për Kryetar të Komunës në zgjedhjet lokale të vitit 2017 dhe para kësaj Gjykate u paraqit në cilësinë e individit, përkatësisht personit fizik; ndërkaq, Lidhja Demokratike e Kosovës ishte subjekti politik përmes të cilit z. Arban Abrashi garonte për Kryetar të Komunës së Prishtinës dhe para kësaj Gjykate u paraqit si subjekt politik, përkatësisht person juridik. Parashtruesit e kërkesës, në thelb, pretenduan se Gjykata Supreme, por edhe PZAP-i, në procedurat e zhvilluara për shqyrtimin e ankesave dhe apeleve të tyre, kanë dështuar të ofrojnë mbrojtje gjyqësore të të drejtave të tyre të garantuara me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe, për pasojë, vendimet e këtyre autoriteve publike, kanë rezultuar në shkelje të të drejtave të tyre zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të garantuara me nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita pasi konstatoi se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar; kontestojnë vendime të autoriteteve publike; kanë shteruar mjetet juridike siç është elaboruar në Aktgjykim; kanë saktësuar të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendojnë se janë shkelur; kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit; kërkesa nuk është qartazi e pabazuar; dhe Gjykata nuk gjeti asnjë kusht tjetër të pranueshmërisë i cili nuk është plotësuar. Si rrjedhojë, kërkesa e kaloi testin e pranueshmërisë dhe u shpall e pranueshme për shqyrtim në merita. Para shqyrtimit të meritave të rastit, Gjykata e trajtoi çështjen e juridiksionit të saj lidhur me kontestet zgjedhore. Në këtë drejtim, Gjykata sqaroi kompetencën e saj kushtetuese për sa i takon kërkesave individuale lidhur me kontestet zgjedhore, duke theksuar se ajo në këtë aspekt, është e kufizuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, përkatësisht në vlerësimin nëse një akt i autoritetit publik mund të ketë shkelur të drejtat

dhe liritë themelore përkatëse individuale dhe pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Gjykata më pas trajtoi të gjitha pretendimet e parashtruesve të kërkesës në veçanti dhe në tërësinë e tyre, duke aplikuar mbi këtë vlerësim: (i) garancitë kushtetuese që ndërlidhen me të drejtat e kontestuara, nenin 45 e 54 të Kushtetutës, respektivisht; (ii) parimet themelore që rezultojnë nga trashëgimia evropiane për zgjedhje demokratike të përmbledhura nga Komisioni i Venecias; dhe (iii) praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Pas aplikimit të këtyre garancive, parimeve dhe testeve të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata njëzëri konstatoi se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme, nuk kanë shkelur të drejtat e parashtruesve të kërkesës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës dhe të drejtën për mjet juridik të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për zgjedhje efektive të garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), sepse në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Supreme, drejtë kishte vlerësuar çështjet që ndërlidhen me: (i) konfirmimin/anulimin e rezultatit zgjedhor; (ii) shpalljen e pasafshme të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës që ndërlidheshin me parregullsitë në ditën e votimit, e të cilat ishin paraqitur për herë të parë në PZAP, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar; dhe (iii) fletëvotimet e pavlefshme dhe të zbrazëta, pasi PZAP-i kishte hetuar materialin zgjedhor në qendrat e kontestuara të votimit dhe kishte konstatuar se parregullsitë nuk *“kanë ndikim në rezultatin final”*.

Për më tepër, vendimet e Gjykatës Supreme ishin *“mjaftueshëm të arsyetuara”* në raport me pretendimet e parashtruesve të kërkesës dhe në harmoni me standardet e përcaktuara me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të vendeve anëtare të Komisionit të Venecias, për sa i përket arsyetimit të vendimeve në konteste zgjedhore. Konstatimet e Gjykatës Supreme u konsideruan të jenë në përputhshmëri me garancitë kushtetuese, me praktikën gjyqësore përkatëse të GJEDNJ-së dhe me parimet themelore të Komisionit të Venecias e që ndërlidhen me një *“sistem efektiv ankesash”*, si pjesë përbërëse të *“garancive procedurale”*, kusht ky thelbësor për jetësimin e pesë parimeve themelore që ndërlidhen me cilësitë e votës. Gjykata po ashtu njëzëri konstatoi se vendimet e kontestuara të Gjykatës Supreme nuk kanë shkelur të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes të parashtruesve të kërkesës të garantuara me nenin 45 të Kushtetutës në lidhje të drejtën për zgjedhje të lira të garantuar me neni 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, sepse, në rrethanat e rastit konkret, të njëjtat nuk janë nxjerrë në kundërshtim me: (i) kushtet për mbrojtjen e parimeve themelore për cilësitë e votës, siç janë të garantuara me Kushtetutë, ligje zgjedhore dhe Kodin e Praktikës së Mirë të Komisionit të Venecias; (ii) kushtin e *“garancive procedurale”* për jetësimin e parimit të *“votës së lirë”* dhe *“votës së barabartë”*; (iii) *“parimin e transparencës”* në konteste zgjedhore, siç është përcaktuar nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të parimeve themelore të Komisionit të Venecias; dhe (iv) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në kontekst të *“të drejtave pas-zgjedhore”*.

Gjykata po ashtu, njëzëri, refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për seancë dëgjimore sepse nuk konsideroi se kishte ndonjë paqartësi rreth *“provave apo ligjit”*. Gjykata konstatoi se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur meritat e këtij rasti. Si rrjedhojë, në fund, Gjykata, njëzëri konstatoi se:

(i) Aktvendimi [AA. nr. 52/2017] i 25 nëntorit 2017 i Gjykatës Supreme nuk është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të subjektit politik LDK, dhe është në përputhshmëri me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 45 e 54 të Kushtetutës; dhe se (ii) Aktgjykimi [A.A. U.ZH. nr. 62/2017] i 7 dhjetorit 2017 i Gjykatës Supreme nuk është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të z. Arban Abrashi dhe të subjektit politik LDK, dhe është në përputhshmëri me të drejtat dhe liritë themelore e tyre të garantuara me nenet 45 e 54 të Kushtetutës.



Aktgjykim

KO 171/18

Parashtrues

Avokati i Popullit

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (paragrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 22, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të caktuara të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (të tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar) dhe kërkoi vendosjen e masës së përkohshme. Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës pretendoi se Ligji i kontestuar nuk është në pajtueshmëri me nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] dhe me Kapitullin VI [Qeveria e Republikës së Kosovës] të Kushtetutës. Pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës ishin rreth: (i) tejkalimit të fushëveprimit të ngushtë të Këshillit, i përcaktuar me Kapitullin VI të Kushtetutës; (ii) shkeljes së pavarësisë kushtetuese të Avokatit të Popullit dhe të institucioneve të tjera të pavarura kushtetuese; dhe (iii) dhënies së imunitetit anëtarëve të Këshillit. Gjykata konstatoi që kërkesa i plotëson kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë e të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës dhe në meritat e Aktgjykimit adresoi secilin pretendim të parashtruesit të kërkesës. Gjykata vlerësoi dhe konstatoi si në vijim:

Së pari, sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me tejkalimin e fushëveprimit të ngushtë të Këshillit,

Gjykata konsideroi se shprehja “Shërbimi Civil” sipas leximit dhe interpretimit të nenit 101 të Kushtetutës, duhet kuptuar në kontekstin e saj dhe në qëllimin që ka pasur hartuesi, qëllim i cili është i shprehur në nenin 1 të Ligjit të Shërbimit Civil, duke evituar kështu mundësinë e keqinterpretimeve ose të interpretimeve teknike të normës në fjalë. Si rrjedhojë, Gjykata konstatoi se neni 2 i Ligjit të kontestuar është në përputhshmëri me nenin 101 [Shërbimi Civil], paragrafin 1 dhe 2 të Kushtetutës.

Së dyti, sa i përket setit të dytë të pretendimeve, Gjykata fillimisht, duke rikujtuar edhe praktikën e saj gjyqësore në të cilën kishte zhvilluar parimet lidhur me pavarësinë e institucioneve të pavarura kushtetuese, theksoi që këto të fundit nuk lirohen nga detyrimi që në rregullore apo në aktet juridike t'i rregullojnë specifikat në lidhje me marrëdhënien e punës, që dallojnë nga normat e përgjithshme të përcaktuara me ligjet e tjera, duke përfshirë edhe Ligjin e kontestuar; dhe gjatë zbatimit të Ligjit të kontestuar duhet t'u njihet funksioni i tyre, ndër të tjera, në nxjerrjen dhe në aplikimin e rregullave të tyre të brendshme për të mbrojtur pavarësinë e tyre të përcaktuar me Kushtetutë dhe në ligje të veçanta, deri në masën e nevojshme, për të mbrojtur pavarësinë e tyre. Ndërsa, sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar në lidhje me institucionet e tjera publike, Gjykata konkludoi se neni 4 (paragrafi 1), në ndërlidhje me nenin 3 (paragrafi 1.1), i cili rregullonte statusin e Këshillit, nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën sepse Gjykata vlerësoi që Këshilli nuk mund të kategorizohet me statusin e institucionit të pavarur kushtetues sipas Kapitullit XII të Kushtetutës. Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së nenit 6 (paragrafi 1.2), dhe nenit 19 (nënparagrafët 5, 6, 7 dhe 8) të Ligjit të kontestuar, nene këto të cilat rregullonin mbikëqyrjen e përgjeshjes së nëpunësve civilë për pozita të nivelit të lartë drejtues nga ana e Këshillit, Gjykata konstatoi se nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Gjykata konsideroi se trajtimi i pabarabartë i shërbyesve civilë në raport me kompetencën e Këshillit për mbikëqyrje të përgjeshjes të shërbyesve civilë, i përcaktuar me këto dispozita të Ligjit të kontestuar nuk është në pajtueshmëri me të drejtën kushtetuese për barazi para ligjit. Gjykata konstatoi që dispozitat vijuese të Ligjit të kontestuar, konkretisht neni 2 për fushëveprimin; neni 3 (paragrafi 1.2, 1.3, 1.4) për përkufizimet “nëpunës civil”, “nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues”, “nëpunës civil i nivelit drejtues”; neni 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4) për kompetencat e Këshillit; neni 11 (paragrafi 3) për imunitetet; neni 18 për mënyrat e vendosjes për ankesat; neni 20 (paragrafi 5) për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit; neni 21 për vendimet e Këshillit; neni 22 për iniciimin e konfliktit administrativ; neni 23 për procedurat në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit; nenit 24 për sanksionet administrative; dhe neni 25 (paragrafët 2 dhe 3) lidhur me bashkëpunimin e institucioneve, të Ligjit të kontestuar, janë në pajtueshmëri me Kushtetutën.

Së treti, Gjykata, marrë pasur parasysh imunitetin e limituar që u garantohet me Ligjin e kontestuar anëtarëve të Këshillit, vlerësoi se masa e përdorur është proporcionale dhe konstatoi që neni 11, paragrafi 3, i Ligjit të kontestuar, është në përputhje me të drejtën për qasje në gjykatë, si pjesë përbërëse e të drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KENDJ-së.

Në fund, në lidhje me vendosjen e masës së përkohshme, Gjykata konsideroi që nuk është e nevojshme të shqyrtohet meqenëse është vendosur për meritat e rastit.



Aktgjykim

KO 43/18

Parashtrues

Albulena Haxhiu, Driton Selmanaj dhe
tridhjetë deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së
Kosovës

*Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së
Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe
Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së
Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë*

Kërkesa ishte parashtruar nga tridhjetë e dy (32) deputetë të
Kuvendit të Republikës së Kosovës bazuar në nenin 113
paragrafi 5 i Kushtetutës.

Objekt i çështjes ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së
neneve 1, 2, 4, 10 (paragrafi 4 nën-paragrafët 1 dhe 2) dhe 11
(paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë
dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së
Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë (Ligji i
kontestuar).

Parashtruesit e kërkesës pretenduan se Ligji i kontestuar, në
tërësi, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën,
përkatesisht se nuk është në pajtueshmëri me nenin 2
[Sovraniteti], nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e
Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], nenin 18 [Ratifikimi i
Marrëveshjeve Ndërkombëtare], nenin 20 [Bartja e
Sovranitetit], nenin 65 [Kompetencat e Kuvendit], nenin 93
[Kompetencat e Qeverisë], dhe nenin 94 [Kompetencat e
Kryeministrit] të Kushtetutës.

Në kuadër të Ligjit të kontestuar ishte paraparë themelimi i
delegacionit shtetëror, fushëveprimi i tij, si dhe ishte
përcaktuar hierarkia institucionale dhe procedura
vendimmarrëse në procesin e dialogut me Republikën e
Serbisë.

Më tej me këtë Ligj, ishte rregulluar dhe funksionimi i
delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës për
dialogun me Republikën e Serbisë, dhe për të njëjtin ishte
paraparë struktura organizative, veprimtaria, si
dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e delegacionit shtetëror.

Parashtruesit e kërkesës në thelb para Gjykatës kishin tri
pretendime kryesore:

(i) *përcaktimi dhe ndryshimi i hierarkisë institucionale
kushtetuese dhe vendimmarrëse në dialogun me Serbinë;*
(ii) *kompetencat ligjore të delegacionit shtetëror ndërhyjnë
drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të pushtetit*

ekzekutiv dhe atij legjislativ, si dhe

(iii) *dhënia e karakterit lex specialis Ligjit të kontestuar.*

Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkuan dhe vendosjen e
masës së përkohshme. Gjykata vlerësoi se kërkesa e
parashtruesve është e pranueshme në bazë të kriterëve të
përcaktuara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën
Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës së Gjykatës
Kushtetuese. Në shtjellimin e meritave të kërkesës, Gjykata
vlerësoi pretendimet e parashtruesve të kërkesës rreth: (i)
*përcaktimi dhe ndryshimi i hierarkisë institucionale
kushtetuese dhe vendimmarrëse në dialogun me Serbinë,*
dhe (ii) *kompetencat ligjore të delegacionit shtetëror
ndërhyjnë drejtpërdrejtë në kompetencat kushtetuese të
pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ, dhe gjeti si në vijim:*

Gjykata konstatoi, se delegacioni shtetëror i cili është
themeluar me Ligjin e kontestuar, nuk është i paraparë me
Kushtetutë, dhe nuk është i paraparë brenda formës së
qeverisjes dhe ndarjes së pushtetit. Si i tillë, delegacioni
shtetëror, nuk mund të përfshihet në ndërveprimin e
ndarjes, kontrollit dhe balancimit të pushteteve dhe nuk
mund të ndërhyjë në formën e qeverisjes, gjegjësisht
strukturën e ndarjes së pushtetit sikurse është e përcaktuar
me nenin 4 të Kushtetutës.

Më tej, Gjykata konstatoi se bartja e kompetencave të
institucioneve kushtetuese tek “mekanizmi i posaçëm” i
krijuar me Ligjin e kontestuar, është ndërhyrje në ushtrimin
e kompetencave të institucioneve të përcaktuara me
Kushtetutë. Bartja e kompetencave tek “mekanizmi i
posaçëm”, paraqet ndërhyrje në formën e qeverisjes,
ndarjen e pushtetit, si dhe nuk është në pajtim me vlerat
demokratike dhe të sundimit të ligjit, siç janë të përcaktuara
me nenin 7 të Kushtetutës, sepse i mvesh Delegacionit
shtetëror funksione të cilat nuk përkojnë me normat
kushtetuese.

Gjykata po ashtu konstatoi se me normat kushtetuese, në
mënyrë shprehimore është paraparë obligimi lidhur me
ushtrimin e kompetencave kushtetuese në sferën e politikës
së jashtme për institucionet kompetente. Kompetenca për të
dialoguar me një shtet të tretë, nuk mund të bartet tek
delegacioni shtetëror si “mekanizëm i posaçëm” përmes një
akti më të ulët juridik, siç është Ligji i kontestuar.

Më tutje, Gjykata konstatoi se Kuvendi i Republikës së
Kosovës është i obliguar ta mbikëqyrë politikën e jashtme
në kuadër të kompetencave kushtetuese të parapara sipas
paragrafit 12 të nenit 65 të Kushtetutës.

Gjykata po ashtu theksoi se paragrafi 1, i nenit 93 të
Kushtetutës i përcakton kompetencat e Qeverisë në
“*propozimin dhe zbatimin e politikës së brendshme dhe të
jashtme të vendit*”, si dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94,
përcaktojnë se Kryeministri si i pari i Qeverisë “*Përfaqëson
dhe udhëheq Qeverinë*” si dhe “*Këshillohet me Presidentin
për zbatimin e politikës së jashtme të vendit*”.

Rrjedhimisht, Gjykata konkludoi se përfaqësimi në sferën e
politikës së jashtme është detyrë e institucioneve
kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kjo kompetence
është e përcaktuar me Kushtetutë, dhe nënkupton, para së
gjithash, që çdo negociim apo veprim tjetër që ka të bëjë me
lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të
Republikës së Kosovës, duhet të jetë brenda detyrimeve
kushtetuese që kanë institucionet e Republikës së Kosovës.
Gjykata po ashtu konkludoi se kompetenca për arritjen e
marrëveshjeve ndërkombëtare, nuk mund të bartet ose
transferohet nga institucionet kushtetuese në një
“mekanizëm të posaçëm” siç parashihet me Ligjin e
kontestuar.



Gjykata njëzëri, vendosi që nenet 1 (paragrafi 1), 2, 4, 10 (paragrafi 4, nën-paragrafët 1 dhe 2), dhe neni 11 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë, nuk janë në pajtueshmëri me paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 1 të nenit 7 [Vlerat], paragrafin 12 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit], paragrafin 1, të nenit 93 [Kompetencat e Qeverisë], dhe paragrafët 1 dhe 9 të nenit 94 [Kompetencat e Kryeministrit] të Kushtetutës.

Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se, meqë nenet thelbësore të Ligjit nr. 06/L-145 për Detyrat, Përgjegjësitë dhe Kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në Procesin e Dialogut me Serbinë nuk janë në pajtueshmëri me Kushtetutën, i njëjti, në tërësinë e tij, është i papajtueshëm me Kushtetutën.



GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 janar – 30 qershor 2019)

*** Turqia dështoi të bashkëpunojë në rastin e vrasjeve, ndërsa Qiproja bëri gjithçka që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme (29/01/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së Madhe në rastin **Güzelyurtlu dhe të tjerët kundër Qipros dhe Turqisë** (kërkesa nr. 36925/07): Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut konstatoi: me 15 vota në dy, **se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën/hetim)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Qipro, dhe njëzëri, se ka pasur **shkelje të nenit 2** të Konventës nga Turqia.

Rasti kishte të bënte me hetimin për vrasjen e tre shtetasve qipriotë me prejardhje turke qipriote në zonën e Qipros të kontrolluar nga Qeveria e Qipros në vitin 2005. Vrasësit ikën në “Republikën Turke të Qipros Veriore” (“RTQV”). Hetimet paralele të vrasjeve u kryen nga autoritetet e qeverisë qipriote dhe të qeverisë turke, duke përfshirë ato të “RTQV”. Të dy hetimet u bllokuan në vitin 2008. Në rastin e tyre para Gjykatës Evropiane, parashtruesit e kërkesës, të afërmit e viktimave, pretendonin se refuzimi i Turqisë dhe Qipros për të bashkëpunuar nënkuptonte se vrasësit nuk ishin përballur me drejtësinë. Gjykata vlerësoi se të dyja shtetet ishin të obliguara të bashkëpunonin me njëri-tjetrin. Ajo konstatoi që Qiproja kishte bërë gjithçka që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme nga ajo për të dorëzuar/ekstraduar të dyshuarit nga Turqia, duke parashtruar kërkesat e “Njoftimit të kuq” në Interpol dhe, kur kjo doli e pasuksesshme, kërkesën për ekstradim në Turqi. Autoritetet qipriote nuk mund të kritikoheshin për refuzimin e paraqitjes së të gjitha provave dhe për të transferuar procedurat tek autoritetet e “RTQV” ose Turqisë. Kjo do të rezultonte që Qiproja të heqë dorë nga juridiksioni i saj penal për një vrasje të kryer në zonën e saj të kontrolluar në favor të gjykatave të një entiteti të panjohur të krijuar brenda territorit të saj. Turqia, nga ana tjetër, nuk kishte bërë përpjekjet minimale të kërkuara në rrethanat e rastit. Ata kishin injoruar kërkesat për ekstradim të Qipros, duke i kthyer ato pa përgjigje, në kundërshtim me obligimin e tyre sipas nenit 2, në dritën e marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, për të bashkëpunuar duke informuar shtetin kërkuar për vendimin e tij dhe në rast të refuzimit, të japin arsyet.

*** MB nuk arriti të mbrojë të drejtën e privatësisë së një aktivisti gjatë gjithë jetës, të dhënat personale të të cilit u shfaqën në një bazë të dhënash ekstremiste (24/01/2019)**

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar** (kërkesa nr. 4514/15), njëzëri, kishte konstatuar se ka pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të

Drejta të Njeriut. Rasti kishte të bënte me ankesën e parashtruesit për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave personale të tij një bazë të dhënash policore për “ekstremistët e brendshëm”. Gjykata gjeti veçanërisht se të dhënat e mbajtura për parashtruesin kishin të bënin me pikëpamjet e tij politike dhe për një informatë të tillë kërkohet mbrojtje e veçantë. Gjykata gjithashtu mori parasysh moshën e z. Catt, (ai tani është 94 vjeç) dhe faktin që ai nuk kishte histori ose perspektivë për kryerjen e akteve të dhunës. Përderisa mbledhja e informatave në lidhje me të justifikohet, mbajtja e tyre jo, veçanërisht për shkak të mungesës së garancive, siç janë afatet kohore. Prandaj, ka pasur shkelje të Konventës.

*** Vërejtjet e dy figurave publike shkelën të drejtën për t'u konsideruar i pafajshëm të një ministri të akuzuar për shpërdorim (31/01/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Maslarova kundër Bullgarisë** (kërkesa nr. 26966/10) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, njëzëri, konstatoi se ka pasur: **shkelje të nenit 6 paragrafi 2 (prezumimi i pafajësisë)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe **shkelje të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive)**. Rasti kishte të bënte me një ankesë të parashtruar nga znj. Maslarova, e cila ishte Ministre e Punës dhe Politikës së Punësimit prej viti 2005 deri në vitin 2009, në lidhje me mosrespektimin e të drejtës së saj që të konsiderohet e pafajshme për shkak të vërejtjeve të bëra nga figura të caktuara politike dhe gjyqësore dhe të transmetuara në shtyp, lidhur me procedurat penale kundër saj për shpërdorimin e fondeve publike. Gjykata gjeti në veçanti se vërejtjet e bëra nga zëdhënësi i zyrës së Prokurorisë së Përgjithshme - gjatë një konference për shtyp për procedurat në fjalë - dhe ato të një anëtarit të Parlamentit i cili ishte gjithashtu zëvendëskryesues i një komisioni parlamentar ad hoc për hetimin e shpenzimeve të qeverisë së mëparshme, kishte shkelur të drejtën e znj. Maslarova për t'u konsideruar e pafajshme pasi ato kishin shkuar përtej përcjelljes së thjeshtë të informatës. Gjykata gjithashtu konstatoi se nuk kishte ndonjë mjet juridik efektiv të brendshëm në dispozicion të znj. Maslarova. Gjykata hodhi poshtë ankesat për komentet që i janë atribuuar Kryeministrit dhe për kërkesën për pezullimin e imunitetit parlamentar të dërguar nga Prokurori i Përgjithshëm tek Asambleja Nacionale përmes kanaleve zyrtare, duke konstatuar se ato ishin qartazi të pabazuara.

*** Dënimi me burg i gazetarit të njohur italian pas dënimit të tij për shpifje ishte “dukshëm joproporcional” (07/03/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj, në rastin **Sallusti kundër Italisë** (kërkesa nr. 23405/13), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, njëzëri, konstatoi se kishte pasur: **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Rasti



kishte të bënte me një gazetar, Alessandro Sallusti, i cili u shpall fajtor për shpifje, u gjobit dhe u dënua me dënim me burg, një pjesë të të cilit ai e vuajti nën arrest shtëpiak. Gjykatat kombëtare konstatuan se artikujt e botuar nën kontrollin e tij kishin raportuar rrejshëm se një vajzë 13-vjeçare ishte detyruar të abortonte nga prindërit e saj dhe një gjyqtar i kujdestarisë, pavarësisht sqarimeve në shtyp një ditë para se vajza kishte dashur të kryente abortin.

Gjykata gjeti se z. Sallusti kishte dëmtuar të drejtat e nderit dhe të privatësisë së vajzës, prindërve të saj dhe gjyqtarit, por se nuk kishte asnjë justifikim për t'i caktuar atij dënim me burg. Një sanksion i tillë kishte shkuar përtej asaj që do të ishte një kufizim "i domosdoshëm" i lirisë së shprehjes së z. Sallusti.

*** Refuzimi i gjykatave vendase për të vendosur përgjegjësi në një forum në internet për komentet e postuara në mënyrë anonime nuk ishte në kundërshtim me nenin 8 (19/03/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj, në rastin **Høiness kundër Norvegjisë** (kërkesa nr. 43624/14), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, njëzëri theksoi se nuk ka pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private)** të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Rasti kishte të bënte me refuzimin e gjykatave të brendshme për të vendosur përgjegjësi civile në një forum në internet pasi ishin postuar komentet vulgare në lidhje me znj. Høiness në atë forum.

Znj. Høiness, një avokate e njohur në Norvegji, filloi procedurën civile pranë Gjykatës së Qytetit të Oslos në maj të vitit 2012 kundër kompanisë Høegh Media AS dhe z. H., një redaktor që punon për portalin në Internet Høegh Online, për shpifje. Ajo deklaroi se nderi i saj ishte shkelur për shkak të ngacmimit seksual në tri komente të bëra në mënyrë anonime në forumin e Høegh Online, i cili ishte inkorporuar në Høegh Media AS. Të pandehurit argumentuan se ata nuk kishin qenë në dijeni të komenteve dhe se ato ishin hequr posa ata ishin vetëdijësuar për to.

Në janar të vitit 2012, Gjykata e qytetit vendosi në favor të të pandehurve. Ajo konstatoi se komentet në fjalë nuk përbënin shpifje të paligjshme pasi ato nuk kanë mundur të ofendonin as nderin dhe as reputacionin e znj. Høiness.

Znj. Høiness apeloj. Gjykata e Lartë konstatoi në tetor të vitit 2013 se kërkesa për kompensim e znj. Høiness nuk mund të kishte sukses, përveç nëse të pandehurit kishin vepruar me faj të mjaftueshëm. Në këtë drejtim, ajo vlerësoi, ndër të tjera, se në faqen e internetit kishte "butona paralajmërimi", ku lexuesit mund të klikonin për të reaguar ndaj komenteve. Gjykata e Lartë gjithashtu mbështeti vendimin e Gjykatës së Qytetit për shpenzimet gjyqësore dhe u aprovoi të pandehurve 183,380 korona norvegjeze (rreth 20,050 euro). Znj. Høiness apeloj, por leja për të apeluar në Gjykatën Supreme iu refuzua. GJEDNJ-ja gjeti në veçanti se gjykatat kombëtare kishin vepruar brenda diskrecionit të tyre ("margjina e vlerësimit") duke

kërkuar të vendosin një balancë në mes të drejtave të znj. Høiness sipas nenit 8 dhe të drejtën e palës kundërshtare të lirisë të shprehjes në bazë të nenit 10 të portalit të lajmeve dhe prezantuesit të forumeve të debateve. Për më tepër, vendimet e gjykatave vendase për shpenzimet gjyqësore që u ishin aprovuar të pandehurve nuk e kishin shkelur nenin 8.

*** Gjykata thotë se Rusia duhet të paguajë deri në 15,000 euro gjeorgjianëve të drejtat e të cilëve janë shkelur nga dëbimet e vitit 2006 (26/03/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Berdzenishvili dhe të tjerët kundër Ruisë** (kërkesa nr. 14594/07 dhe gjashtë të tjerët), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, njëzëri, konstatoi që Rusia duhej të paguante shumën që fillonin me 2,000 euro deri më 15,000 euro për qytetarët gjeorgjianë, që iu nënshtruan një praktike administrative të arrestimit, paraburgimit dhe dëbimit në tetor të vitit 2006.

Parashtruesit e kërkesës u ankuan se ata ishin në mesin e gjeorgjianëve të cilët ishin arrestuar dhe dëbuar nga Rusia në vjeshtën e vitit 2006, incidente të cilat nxitën qeverinë gjeorgjiane që të ngrinte padi kundër qeverisë ruse. Në aktgjykimin e saj kryesor, Gjykata gjeti se shumica e 19 parashtruesve në këtë rast kishin pësuar shkelje të të drejtave të tyre sipas neneve të ndryshme të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo vonoi një vendim për kompensim të drejtë, në pritje të një vendimi mbi të njëjtën çështje nga Dhoma e Madhe në Gjeorgji kundër Ruisë (I) lidhur me një numër të madh të parashtruesve të tjerë gjeorgjianë. Dhoma e Madhe solli vendimin e saj për përmbushje të drejtë në janar të vitit 2019. Ajo aprovoi 10 milionë euro për t'u ndarë në mes të viktimave në atë rast dhe duke vendosur parime për shpërndarjen e asaj shume. Dhoma zbatoi të njëjtat parime në rastin e tanishëm.

Në rastin Berdzenishvili dhe të tjerët, Dhoma e Gjykatës në vitin 2016 konstatoi shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4 (ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve) në lidhje me 14 parashtrues. Ajo gjithashtu, konstatoi se 13 parashtrues kishin pësuar shkelje të nenit 5 §§ 1 dhe 4 (e drejta për liri dhe siguri/e drejta për ligjshmëri të paraburgimit të vendosur me shpejtësi nga gjykata); të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues); dhe të nenit 13 (e drejta për zgjidhje efektive) në lidhje me nenin 3.

*** Vlerësimi joadekuat i një urdhri për dëbim kundër një shtetasi kosovar ishte në kundërshtim me Konventën (09/04/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **I.M. kundër Zvicrës** (kërkesa nr. 23887/16), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, njëzëri, konstatoi se do të kishte **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në qoftë se I.M. do



të dëbohej në Kosovë. Rasti kishte të bënte me refuzimin e autoriteteve zvicerane për të ripërtërirë lejen e qëndrimit të I.M. (një shtetas kosovar që ka jetuar në Zvicër që nga viti 1993) dhe urdhrin që për dëbim të tij nga territori zviceran, pas dënimit të tij për një dhunim të kryer në vitin 2003. I.M., shkalla e aftësisë së kufizuar e të cilit është vlerësuar në 80%, aktualisht jeton në Zvicër me fëmijët e rritur, ndaj të cilëve ai është i varur. Gjykata gjeti veçanërisht se Gjykata Federale Administrative, kur ka gjykuar në vitin 2015 – përkatësisht për më shumë se 12 vjet pas kryerjes së veprës penale nga parashtruesi - nuk kishte marrë parasysh ndryshimin në sjelljen e parashtruesit apo vlerësuar ndikimin e rënies së madhe në gjendjen e shëndetit në rrezikun e rikthimit të shkeljeve të ligjit. Gjykata Federale Administrative nuk kishte marrë parasysh fuqinë e lidhjeve shoqërore, kulturore dhe familjare të parashtruesit me vendin pritës (Zvicrën) dhe vendin e destinacionit (Kosovën), dhe as nuk kishte kryer një analizë të mjaftueshme të implikimeve të varësisë së I.M. në fëmijët e tij të rritur. Autoritetet vendase kishin kryer një shqyrtim sipërfaqësor të proporcionalitetit të urdhrit për dëbim dhe kishin dështuar në mënyrë bindëse për të demonstruar se ishte në përpjesëtim me qëllimet legjitime që synonin të arriheshin (parandalimin e çrregullimit ose krimit) dhe të domosdoshme në shoqërinë demokratike.

*** Refuzimi për të lejuar një të burgosur të dënuar për vepra terroriste për të udhëtuar në funeralin e babait të saj nuk e ka shkelur Konventën (11/04/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj, në rastin **Guimon kundër Francës** (kërkesa nr. 48798/14), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, njëzëri, konstatoi se nuk ka pasur: **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me refuzimin e lejimit të parashtrueses së kërkesës, e cila ishte burgosur në Rennes për vepra terroriste, të udhëtonte në ceremoni të varrimit në Bayonne për t'i shprehur nderimet e fundit babait të saj të ndjerë. Gjykata vlerësoi se autoritetet kishin refuzuar kërkesën, së pari, për shkak të profilin kriminal të parashtrueses - ajo po vuante disa dënime me burg për vepra terroriste dhe vazhdoi të pohonte anëtarësimin e saj në ETA - dhe, së dyti, sepse ishte e pamundur të organizohej një përcjellje e sigurisë së përforcuar brenda kohës në dispozicion. Gjykata konstatoi se shteti i paditur nuk kishte tejkaluar lirinë e vlerësimit të ofruar në këtë fushë dhe se refuzimi për të aprovuar kërkesën e parashtrueses nuk kishte qenë joproporcional dhe kishte ndjekur synime legjitime.

*** Vendimi për pezullimin e seancës plenare të Parlamentit të Bashkësisë Autonome të Katalonisë ishte në pajtim me Konventën (28/05/2019)**

Në vendimin e saj në rastin e **Forcadelli Lluís dhe të**

tjerët kundër Spanjës (kërkesa nr. 75147/17) Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut njëzëri e **deklaroi kërkesën të papranueshme**. Rasti kishte të bënte me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Spanjës për të pezulluar seancën plenare të Parlamentit të Bashkësisë Autonome të Katalonisë më 9 tetor 2017. Më 1 tetor 2017, një referendum i paautorizuar u mbajt për të vendosur për shkëputjen e Katalonisë nga territori spanjoll. Më 4 tetor 2017, dy grupe parlamentare (që përfaqësonin 56.3% të të gjitha vendeve në Parlament) kërkuan që Byroja e Parlamentit të Katalonisë të mbledhte një seancë plenare të Parlamentit, gjatë së cilës kryetari i Qeverisë së Katalonisë do të kishte vlerësuar rezultatet e referendumit të 1 tetorit dhe efektet e këtyre rezultateve, në pajtim me nenin 4 të Ligjit nr. 19/2017 për “referendumin e vetëvendosjes”. Byroja e aprovoi kërkesën dhe takimi u programua për orën 10 paradite më 9 tetor. Tri grupet e tjera parlamentare (që përfaqësonin 43.7% të vendeve) kontestuan thirrjen e asaj seance, me arsyetimin se kjo do të shkelte Rregulloren e Parlamentit të Katalonisë. Gjashtëmbëdhjetë deputetë socialistë aplikuan në Gjykatën Kushtetuese për vendosjen e një mase të përkohshme që do të pezullonte seancën plenare. Gjykata Kushtetuese e deklaroi kërkesën të pranueshme dhe urdhëroi pezullimin e përkohshëm të seancës plenare. Në vendimin e saj, GJEDNJ konstatoi se ndërhyrja në të drejtën e parashtruesve për lirinë e mbledhjes mund të konsiderohet në mënyrë të arsyeshme si një “nevojë urgjente sociale”. Pezullimi i seancës plenare të Parlamentit të Bashkësisë Autonome të Katalonisë ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”, në veçanti në interes të sigurisë publike, për parandalimin e trazirave dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, në kuptim të nenit 11 § 2 të Konventës. Për më tepër, Gjykata vërejti se vendimi i Byrosë së Parlamentit për të mbledhur një seancë plenare përbënte shkelje të dukshme të vendimeve të dhëna më parë nga Gjykata Kushtetuese, duke synuar mbrojtjen e rendit kushtetues.

*** Gjykatat nuk kishin vlerësuar dëshminë e bashkëpunëtorit të pretenduar me shërbimet e sigurimit të ish-regjimit komunist (06/06/2019)**

Rasti **Bileski kundër Maqedonisë së Veriut** (kërkesa nr. 78392/14) kishte të bënte me procedurat e iniciuara kundër tij për bashkëpunim të pretenduar me shërbimet e sigurimit të regjimit ish-komunist. Në vitin 2012, Komisioni i verifikimit të fakteve të Maqedonisë së Veriut gjeti se z. Bileski ishte një “ndërlidhës operacional” në ish-shërbimet e sigurisë në këmbim të promovimit, se bashkëpunimi i tij kishte qenë i vetëdijshëm dhe se ai u kishte shkakuar dëm të tjerëve. Vendimi u bazua në veçanti në shënimet e njërit nga stërvitësit e tij të pretenduar. Në procedurat pranë gjykatave administrative, ai kontestoi edhe gjetjet e Komisionit edhe vërtetësinë e dokumenteve.



Ai kërkoi që gjykatat të dëgjojnë prova gojore nga stërvitësi dhe një ekspert, përkatësisht një profesor universitar dhe ish-zyrtar i shërbimit të inteligjencës. Gjykatat administrative hodhën poshtë pretendimet e tij pa shqyrtuar dëshmitarët e propozuar. Në vitin 2013, gjykata më e ulët administrative konstatoi në veçanti se parashtruesi “nuk kishte paraqitur asnjë provë që çoi në fakte të ndryshme”. Në vitin 2014, Gjykata e Lartë Administrative e mbështeti atë vendim, duke konsideruar se bashkëpunimi i pretenduar ishte në pajtim me kushtet e kualifikimit ligjor dhe se “raportet e hartuara nga stërvitësit duhet të konsiderohen si fakte”. Duke u mbështetur veçanërisht në nenin 6 § 1 (e drejta për gjykim/seancë dëgjimore të drejtë) të Konventës, z. Bileski u ankua se atij nuk i është dhënë mundësia që çështja e tij të paraqitet në mënyrë efektive. Në veçanti, gjykatat nuk kishin vlerësuar asnjë nga provat që ai kishte propozuar, duke refuzuar të shqyrtoj dëshmitarët ose të mbajë një seancë dëgjimore, pavarësisht kërkesave të përsëritura; dhe as nuk kishin ofruar arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre. Atij gjithashtu i ishte dhënë qasje e kufizuar në dosjet e shërbimit të sigurisë. Gjykata konstatoi **shkelje të nenit 6 § 1 (e drejta për gjykim të drejtë)** për shkak të padrejtësisë së përgjithshme të procedurës së lustrimit dhe i aprovoi atij 2.400 euro (për dëm jo-material) dhe 300 euro (kostot dhe shpenzimet).

*** Ekstradimi i pesë mësuesve të shkollave në Turqi për shkak të lidhjeve të pretenduara me lëvizjen Gylen ishte në kundërshtim me Konventën (11/06/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Ozdil dhe të tjerët kundër Republikës së Moldavisë** (kërkesa nr. 42305/18), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, njëzëri, kishte konstatuar se ka pasur **shkelje të nenit 5 § 1 (e drejta për liri dhe siguri)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe

shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare). Më tej, ajo deklaroi ankesën sipas nenit 6 § 1 (e drejta për gjykim të drejtë) të papranueshme. Rasti kishte të bënte me ekstradimin e maskuar të pesë shtetasve turq të kërkuar nga autoritetet turke për lidhjet e pretenduara me lëvizjen Fethullah Gülen. Gjykata konstatoi në veçanti se arrestimi i parashtruesve dhe ekstradimi i tyre në Turqi përbënte një transferim jashtë-ligjor nga territori i shtetit të paditur në Turqi, që kishte anashkaluar të gjitha garancitë që u ofroheshin parashtruesve me ligjin e brendshëm dhe ndërkombëtar.

*** Duke ua mohuar përdorimin e kompjuterit dhe qasjen në internet dy të burgosurve, autoritetet turke kishin shkelur të drejtën e Konventës për arsim (18/06/2019)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin **Mehmet Reşit Arslan dhe Orhan Bingöl kundër Turqisë** (kërkesa nr. 47121/06), Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, njëzëri, konstatoi se ka pasur **shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1 (e drejta për arsim)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me të drejtën për arsim të dy të burgosurve të dënuar. Duke qenë të dënuar me burgim të përjetshëm dhe duke dëshiruar të vazhdojnë studimet e tyre të arsimit të lartë, të cilat ishin ndërprerë me dënimin e tyre, parashtruesit kishin kërkuar nga autoritetet e burgut që t'i lejonin ata të përdorin një kompjuter dhe të kenë qasje në internet. Kërkesat e tyre u refuzuan. Ata u ankuan në gjykata por nuk ishin të suksesshëm. Duke shqyrtuar rrethanat, Gjykata gjeti se gjykatat e brendshme nuk kishin arritur të vlerësonin interesat e parashtruesve nga njëra anë dhe detyrimet e rendit publik nga ana tjetër.

(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: www.echr.coe.int)



INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 784 m² hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10 000 - Prishtinë

Tel: +383 (0)38 60 61 62

Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576

Fax: +383 (0)38 60 61 70

E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org

Ueb: www.gjk-ks.org